



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 642/12 Prot.

Pogradec, më 26.02.2024

VENDIM

NR 16, DATË 23.02.2024

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC NR. 151, DATË 28.12.2023 "PËR MIRATIMIN E NORMAVE, KRITEREVE, RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR MARRJE AMBIENTI DHE OBJEKTI ME QIRA, TË CILAT DO TË SHËRBEJNË SI KOPËSHT DHE SHKOLLË PËR ARSIMIN 9-VJECAR, DERI NË PËRFUNDIM TË PLOTË TË RIKONSTRUKSIONIT TË SHKOLLËS "MYREDIN BASHALLI", LIN, NJËSIA ADMINISTRATIVE UDËNISHT, BASHKIA POGRADEC"

Në mbështetje të shkronjës "a", shkronjës "c" të pikës 1.2 të nenit 9, në pikën 11 dhe 12 të nenit 23, shkronjës "k", të nenit 54, në shkronjën "b" dhe shkronjën "gj" të nenit 64, të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenin 28 të Ligjit Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr.10926, datë 08.07.2011, "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, nenit 801 e vijues të Ligjit Nr. 7850, datë 29.7.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", në zbatim të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec Nr.151, datë 28.12.2023, "Për miratimin e normave, kritereve, rregullave dhe procedurave për marrje ambienti dhe objekti me qira, të cilat do të shërbejnë si kopësht dhe shkollë për arsimin 9-vjecar, deri në përfundim të plotë të rikonstruksionit të shkollës "Myredin Bashalli", Lin, Njësia Administrative Udënisht, Bashkia Pogradec", i konfirmuar me shkresën Nr.7/1 Prot., datë 10.01.2024, "Mbi bazueshmërinë ligjore të akteve të Këshillit", e protokolluar pranë Bashkisë Pogradec me Nr.171 Prot, datë 11.01.2024, si dhe mbështetur tek Relacioni shpjegues i Qendrës Arsimore, pranë Bashkisë Pogradec,

**KËSHILLI I BASHKISË
VENDOSI:**



1. Në vendimin e këshillit bashkiak Pogradec nr. 151 datë 28.1.2023 "Për miratimin e normave, kritereve, rregullave dhe procedurave për marrje ambienti dhe objekti me qira, të cilat do të shërbejnë si kopësht dhe shkollë për arsimin 9-vjecar, deri në përfundim të plotë të rikonstruksionit të shkollës "Myredin Bashalli", Lin, Njësia Administrative Udënisht, Bashkia Pogradec", në pikën 1 të këtij vendimi shtohet pika 1.3 dhe pika 1.4 si më poshtë:

1.3 Shtohet një ambient i ri, i cili do të funksionojë si kopësht ose shkollë, pa qera, i ofruar nga një banor i fshatit Lin, ku do të kryhet pagesa e shpenzimeve mujore vetëm për konsumin e energjisë elektrike pranë OSHEE Pogradec dhe e konsumit të ujit të pijshëm pranë UK Pogradec sh.a.

1.4 Marrëdhëniet financiare për pagesën e shpenzimeve mujore të energjisë elektrike dhe konsumin e ujit të pijshëm për ambientin e ofruar të fillojnë nga data 10.01.2024, datë e cila përkon me konfirmimin e shkresës Nr. 7/1 Prot., deri në përfundim të kontratës.

2. Pikat e tjera nga nr.2-5 të VKB-së nr. 151, datë 28.12.2023 "Për miratimin e normave, kritereve, rregullave dhe procedurave për marrje ambienti dhe objekti me qira, të cilat do të shërbejnë si kopësht dhe shkollë për arsimin 9-vjecar, deri në përfundim të plotë të rikonstruksionit të shkollës "Myredin Bashalli", Lin, Njësia Administrative Udënisht, Bashkia Pogradec", do të mbeten të pandryshuara.

3. Për zbatimin e vendimit, ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe e Prokurimeve Publike, Qendra Arsimore e Bashkisë si dhe administrata e Bashkisë Pogradec.

4. Ky vendim hyn në fuqi, 10 ditë pas shpalljes.

NËN/KRYETARË TË KËSHILLIT

Miranda OLLDASHI



1. Miratuar me 17 vota

2. Vota Pro 17

3. Vota Kundër 0

4. Vota Abstenim 1

5. Zbardhur më date 26.02.2024